



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KUÇOVË
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT**

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Materiale Pastrimi”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi PCV Produkte pastrimi 39830000-9.

VLERA E FONDIT LIMIT :

Fondi Limit për 1(një) vit kalendarik : **1 663 700** (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind) **Lekë paTVSH**, dhe fond limit total për 2 (dy) vjet : **3 327 400 (tre milion e tre qind e njëzetë shtatë mijë e katërqind) Lekë pa T.V.SH** , të vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Kuçovë .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Qendra Ekonomike e Arsimit pranë Bashkisë Kuçovë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim të deklaratave të xhiros vjetore për tre vitet e fundit ushtrimorë duke filluar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të ketë një vlerë jo më të ulët se 30% e vlerës së fondit limit që prokurohet.

2.2.3 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin vërtetim për shlyerjen për taksat vendore për vitin 2026, në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” kudo që operatori ekonomik ka ushtruar aktivitet sipas QKB sipas afateve të pagesave të caktuar nga organet e njesive vendore ku operatori ushtron aktivitetin.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin E Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Për Taksat Lokale

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa e fjetjes në hotel.
4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.
7. Taksa për zënien e hapësirave publike.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiscal”.

Bazuar mbi sa më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për pagesën e taksave lokale për vitin 2026 është në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore " dhe në proporcion të drejtë me objektin e prokurimit, nga ku operatorët ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë vërtetimin për pagesën e vitit 2021 (i cili paguhet jo më vonë se data 20 janar të vitit pasardhës).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit ushtrimore duke filluar nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 15 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruara ne organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më pak se 15 % të vlerës së fondit limit që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për materiale e pastrimit kryesisht për detergjentet të cilët duhet të jenë të pajisur me të dhenat e siguris. Në rast të se do të paraqes autorizim nga distributori i autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar nga prodhuesi .

Argumentim: Në bazë të nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për të vërtetuar se mallrat objekt prokurimi janë në shumicën e tyre detergjent pastrimi atëherë lind nevoja që të kërkohen garanci të produkteve të pastrimit (detergjentë, dezinfektues, zbardhues, etj.) per menyren e furnizimit duket garantuar AK per zbatimin e kontrates me sukses dhe ne kohe .

Për sa më lart Autoriteti Kontraktor e lidhë ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit këtë kërkesë.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues, për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 1 (një) – punonjës shofer i pajisur me lejen e drejtimit që të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën ditën e hapjes së ofertave, i nevojshëm për shpërndarjen e mallrave në ambjentet e caktuara prej autoritetit kontraktor sipas grafikut të lëvrimin, për sa kohë AK pret të furnizohet me mallra objekt prokurimi pranë Qendrës Ekonomike të Arsimit dhe jo ti blejë ato pranë ambjenteve të operatorit ekonomik që do të shpallet fitues.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri prej minimalisht 1 (nje) – person që të figurojën në listëpagesat e shoqërise ne daten e hapjes se ofertave, ku duhet të jetë shoferë i pajisur me lejen e drejtimit, , për shpërndarjen e mallrave në ambjentet e caktuara prej autoritetit kontraktor.

Nisur dhe nga grafiku i lëvrimin të mallrave të hartuar nga Qendra Ekonomike e Arsimit si në vitet paraardhës, njësia e prokurimit gjykon se ka vendosur një numër minimal punonjësish dhe se, qëllimi i autoritetit kontraktor është zbatimi i kontratës me sukses dhe në kohë duke mos sjellë vonesa në lëvrimin e mallrave objekt prokurimit.

Gjykuar nga sa më sipër, njësia e prokurimit vlerëson se ka kërkuar një numër minimal punonjësish që duhet të disponojnë operatorët ekonomik ofertues në përmbushje të zbatimit të kontratës në koh.

2.3.4 Operatorët ekonomik ofertues duhet të disponojnë dhe paraqesin çertifikatën sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht :

1.ISO 9001 : 2015 (Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent e njohur nga DPA.

2. ISO 14001 : 2015 (Çertifikatë për Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit) ose ekuivalent e njohur nga DPA.

Argumentim: Në bazë të dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

ISO (Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, jo-qeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë . Në nivel botëror shoqëritë ndjekin adoptimin e standarteve të cilësise me qëllim që të jenë të respektuar nga klientet e autoritetet shtetërore dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qendrueshëm me avantazhe reciproke.

- **ISO 9001 - 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent**

Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të cilësisë, është **standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar**. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit . (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë sepse kemi të bëjmë me produkte pastrimi dhe dizifektimi ku cilësia e produktit ka rëndësi për shkak dhe të kohës pandemike që po jetojmë dhe produktet e pastrimit do të përdoren për kopshte , çerdhe,shkolla dhe zyra nga Q.E.Arsimit) .

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kërkesat e mësipërme janë në përpjestim dhe përputhje të plotë me objektin e kontratës, për sa kohë i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor.

- **ISO 14001 (Çertifikatë për Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit) ose ekuivalent.**

Ky çertifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky çertifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor .

Kjo çertifikatë është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Referuar objektit të prokurimit “ Blerje Materiale Pastrimi ” në rastin konkret duke parë dhe preventivin i cili përmban edhe produkte që dëmtojnë direkt mjedisin si psh ; Pluhur larje , Leng zbardhues rrobash , Xhel për larje enesh, Sapun rrobash 125 gr, Sapun fytyre 90 gr, Leng larje pllakash 1 liter,Pastrues sobe 550 gr,Laç mizash , Pulirapid për grupet e inoksit , Antikalgare për lavatrice , Acid për këtë arsye njësia e prokurimit e ka parë të nevojshme që shoqëritë të jenë të çertifikuara nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi të.

- **ISO 14001** Sistemi i Menaxhimit Mjedisor është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të ndryshme në mjedis. Ky sistem i lejon pronarët e bizneseve të ndryshme dhe menaxherët të jenë më të vetëdijshëm për përgjegjësitë mjedisore, duke përfshirë përgjegjësitë ligjore dhe rregullatore, për të menaxhuar rreziqet në mënyrë korrekte dhe për të krijuar mekanizmat e nevojshëm të kontrollit.

2.3.5 **Materialët e Pastrimit** të jenë cilësorë sipas preventivit dhe specifikimeve teknike të mallrave, Afati i skadences: (për mallrat të cilat kanë skadencë) data e skadences në ditën e levrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadences.

Ky kriter është kriter që rrit sigurin tek Autoriteti Kontraktor që mallrat janë cilësor dhe kanë afat përdorimi .

- **Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**
- **Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**
- **Dhënia e informacionit të rremë, përbën shkak për skualifikim, si dhe do të vepron konform parashikimeve të LPP.**

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MALLRAVE OBJEKT PROKURIMIT

MATERIALE PASTRIMI

- 1. Lëng larje pllakash 1 lit :** me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Ambalazhimi duhet të jetë në shishe plastike. Gjendja fizike : të jeteë solucion lëng me aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjen. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë jetë 0.9 gr/cm³- 1.1 gr/cm³. Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
- 2. Pastrues xhamash ,** me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave . Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi . Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen , të ketë aromë parfumi . Vlera e PH 5 deri në 11. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Solucioni të jetë homogjen dhe të ketë densitet 0.9 gr\ cm³ deri në 1.2 gr\ cm³ . Paketim 750 ml. Lënda tensiooaktive të variojë nga 1.0% deri në 4.0 %.
- 3. Sapun rrobash:** Të jetë cilësor , me aftësi shkumuese të lartë . Paketim 125 gr . Ambalazhimi nga fabrika . Paraqitja fizike të jetë I ngurtë , paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës . Vlera e Ph të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë 0.9 deri në 1.2 gr\cm³ . Tretshmëria në ujë të jetë jo më e vogël se 95%. Lartësia e shkumës të jetë jo më e madhe se 5 cm .
- 4. Sapun fytyre :** Të jetë cilësor , me aftësi shkumuese të lartë. Paketim 100 gr. Ambalazhimi nga fabrika. Paraqitja fizike të jetë I ngurtë , paketimi të ketë të evidentuar markën dhe barkodin e prodhimit të fabrikës . Vlera e Ph të jetë 7 deri në 10. Densiteti të jetë nga 0.9 deri në 1.2 gr\cm³ . Tretshmëria në ujë jo më e vogël se 95% . Lartësia e shkumës të më e vogël se 5 cm .
- 5. Acid për pastrim 1 lit ,** të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive . Ambalazhimi në shishe plastike . Të përmbajë në masën 12% deri në 30 % acid klorhidrik . Vlera e Ph 0- 3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri në 1.5 gr\cm³ . Të jetë I tretshëm në ujë 100%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
- 6. Detergjent për grupe inoksi (Pulirapid ose ekuivalente) :** Ambalazhimi në shishe plastike 750 ml për larje të lavamanit , sanitaret e tualetit, të pastrojë në thellësi kripërat e ujit nga hidrosanitaret. Të parandalojë krijimin e kripërave. Të ketë

aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

- 7. Solucion për e smërcit/ kripërave për lavatriçe (Anticalgare ose ekuivalente) :** Të jetë masë e pluhurizuar dhe granular për përdorimin në lavatriçe . Ambalazhimi të jetë bërë nga fabrika në kuti kartoni trajtë puhuri. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
- 8. Ilaç mizash dhe mushkonjash:** Spray me ambalazhim në paketim plastic. Të jetë me aromë jo shumë të forte.
- 9. Detergjente lares për WC (Ace ose ekuivalent),** ku përmbajtja e hipoklorit të natriumit të jetë 3-4% . Detergjenti të jete dizifektant dhe zbardhues ndersa ambalazhimi të jetë me bidona plastic me sasi 2.5 liter .Gjendja fizike të jetë solucion homogjen me aromë lehtë klorigjithashtu produkti duhet të ketë të dhënat e produkti dhe prodhuesit .
- 10. Fshesë merimangash.** Fshesa për pastrimin e merimangave , të jetë e përbërë me fije të dendura e të buta plastike me gjatësi mbi 10 cm. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme.
- 11. Bishta fshese merimangash.** Bishti të jetë I gjatë jo më I shkurtër se 100 cm, I përbërë materiali metalik I veshur me një shtesë plastike. Fshesa dhe shkopi të kenë mekanizmin rrotullimit nga e djathta në montim.
- 12. Fshesë furçë.** Fshesa të jetë me fije të dendura , të buta plastike, me gjatësi mbi 10 cm . Të jetë për pastrim të ambienteve të brëndshme . Të jenë rezistentë gjatë forcës së fshirjes së sipërfaqes. Koka të jetë e montueshme dhe e çmotueshme me mekanizmin e rrotullimit nga e djathta në montim me shkopin. Vëndi I vendosjes së shkopit të jetë standart. Peshë e saj të jetë jo më e vogël se 340 gr.
- 13. Fshesë për pastrim territori, melakuqe.** Fshesa të jetë për pastrimin e territoreve të jashtme, e përbërë nga fije melakuqe të dendura dhe të kapura fort me njera tjetrën. Gjatësia e fijeve të fshesës të jetë mbi 40 cm. Shkopi fshesës të jetë me gjatësi mbi 1 metër.
- 14. Lopata mbeturinash.** Të jetë në formë kutie e hapur nga përpara për mbledhjen e papastërtive të ndryshme, e pajisur me një bisht plastik.
- 15. Bishta për shtupa :** jo më të shkurtër se 120 cm. Materiali i shkopit të jetë alumini me veshje plastike. Të ketë mekanizëm montues (efekt vidhimi) dhe shumë rezistent.

- 16. Lecka larje dysHEMEJE :** të jetë e përbërë nga fibra tekstili me përbërje pambuku që thithin ujin shumë mire.
- 17. Furça për pastrimin e WC:** të jetë me fije të forta sintetike. Furça për pastrim efikas dhe higjienik për pastrimin e sipërfaqeve të vështira. Furça të ketë mbajtësen e saj. Të jetë me peshë jo më shumë se 300 gr.
- 18. Peceta pastrimi:** Të jenë të paketuara në qese min 3 fije/pako. Të jenë më shumë se një përdorimëshe. Të kenë veti të mira përthithëse.
- 19. Kosha të mëdhenj mbeturinash ,** të jenë forma të ndryshme, me kapak nga sipër që hapet plotësisht. Të ketë dy doreza në pjesën anësore me qëllim transportimin e tij. Kapaciteti mbajtës I koshit të jetë me volum minimal 50 litër.
- 20. Kovë larje,** të jetë plastike, me kapacitet min 13 litër, e thellë dhe të kenë një dorezë mbajtëse nga sipër për transportimin e kovës.
- 21. Shtrydhëse kove,** e cila përdoret për kova larje me kapacitet min 13 litër.
- 22. Qese të vogla ushqimore,** (min 10 fije/pako): Të jenë rezistentë. Të jenë të paketuara në formë ruloje në numër të ndryshme fijesh (min 10fije/pako) dhe të kenë dy krahe për kapjen e tyre për transport. Të jetë produkt i biodegradueshëm.
- 23. Dorashka për pastrim ,** material gome, të jenë rezistentë të mire ndaj kimikateve të detergjentëve dhe kimikateve të pastrimit. Të jenë për përdorim të larjes së murit e pllakave. Të jenë të qëndrueshme dhe të përshtatshme në përdorim dhe të padepërtueshme nga lëngjet me masa M L.
- 24. Sfungjer enësh,** të jenë të përdorshme për pastrim pjatash, tenxheresh dhe kazanësh. Të jetë me pore të vogla në përbërjen e sfungjerit dhe me rrjete teli të butë për pastrim sipërfaqesh të ashpra.
- 25. Tel enësh:** Të jenë të rezistueshme, të përshtatshëm për larje tenxheresh dhe kazanësh. Të jenë material që nuk ndryshket.
- 26. Detergjent pastrimi sobe,** me veti shumë të mira pastrimi, paketim plastik 500 gr dhe në forëm pluhri me aromë të lehtë .Të jetë i lehtë në përdorim dhe të ketë efekt gërryes në sobë gjithashtu produkti duhet të ketë të dhënat e produkti dhe prodhuesit .
- 27. Detergjent enësh në forëm xheli ,** Detergjent enësh aromatik eko bio i aftë për të lëmuar yndyrnat e papastërtisë të vështira nga pjatat, enët dhe gotat. Të ketë një veprim të qëndrueshëm shkumëzim në lidhje me mjedisin. Të jetë i përbërë nga surfkatantë me

originë natyrore i biodegrueshëm dhe i testuar nga OECD 301. Produkti të jetë i testuar dermatologjikisht, dhe të ketë një efekt jo irritues për lëkurën e duarve. Të mos përmbajë fosfatedhe produkte me originë shtazore. Paketim 400 gr.

28. Pluhur larje lavatriçe, Detergjent rrobash aromatik i përqëndruar për rroba delicate, rroba të leshta, mëndafsh dhe me ngjyra. Të ketë përbërës cilësor për ruajtjen e karakteristikave origjinale të rrobave pas larjes. Me $\text{PH} \leq 2.5$ deklarata e produkteve mjedisore e bazuar sipas ISO 14025-EN 15804. Surfaktantët të jenë të biodegradueshëm sipas dispozitave të reg Evropian 648/2004/CE. Amballazh 3 kg. Materialet e amballazhit të jenë të riciklueshme.

29. Pluhur larje me dorë, Detergjent rrobash aromatik i përqëndruar për rroba delicate, rroba të leshta, mëndafsh dhe me ngjyra. Të ketë përbërës cilësor për ruajtjen e karakteristikave origjinale të rrobave pas larjes. Me $\text{PH} \leq 2.5$ deklarata e produkteve mjedisore e bazuar sipas ISO 14025-EN 15804. Surfaktantët të jenë të biodegradueshëm sipas dispozitave të reg Evropian 648/2004/CE. Amballazh 3 kg. Materialet e amballazhit të jenë të riciklueshme.

30. Kosha rrjet për mbeturinat , në formë rrethore të përshtatshme për mbetje të ndryshme.

31. Kosha rrjet për rroba, në formë rrethore të përshtatshme për mbajtjen e rrobave të palara me vëllim min 20 lit..

Furnizimi do të bëhet sipas kërkesave nga Qendra Ekonomike e Arsimit , Bashkia Kuçovë .

Malli të jetë i sistemuar në amballazhet përkatëse në momentin e dorëzimit .

NJËSIA E PROKURIMIT